

## KOMUNA E JUNIKUT 2017: PROBLEMET KRYESORE DHE TRENDET BUXHETORE

### Hyrje

Komuna e Junikut udhëhiqet nga Agron Kuçi i cili vjen nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës. Ky është mandati i tretë që e ka fituar në zgjedhjet e fundit lokale më 2013.

Në zgjedhjet e kaluara lokale, kandidatët për kryetarë kanë dhënë premtime të cilat nuk bien nën kompetencat vetanake të komunave. Megjithatë, hulumtimet tregojnë se qytetarët e Kosovës kanë njohuri të mjaftueshme mbi ndarjen e kompetencave në mes të pushtetit qendror dhe lokal.<sup>1</sup> Mbi 90% e qytetarëve të Junikut besojnë që pushteti lokal mund t'i zgjidhë të gjitha apo disa nga problemet me të cilat ballafaqohen ata në komunën e tyre.<sup>2</sup> Ndërsa sa i përket shkallës së kënaqshmërisë së qytetarëve të Junikut me pushtetin lokal (Kryetarin e Komunës, Kuvendin Komunal dhe Administratën Komunale), del se ka një rënie të theksuar të kënaqshmërisë nga 63.23 pikë në vitin 2012 në -22.73 në vitin 2015<sup>3</sup>

Në hulumtimin e zhvilluar në fund të vitit 2013 nga Instituti GAP, problemet kryesore në Komunën e Junikut kanë qenë: problemi me mbeturina, kundërmimi i kanalizimit, prerja e pyjeve, mungesa e sallave të mbyllura të edukatës fizike, mungesa e çerdhes, mungesa e stacionit të autobusëve, mungesa e stafit mjekësor.

---

<sup>1</sup> Instituti GAP, Adresimi i Përgjegjësisë: Njohuritë e qytetarëve me kompetencat e komunave. Maj 2017. Burimi: <http://bit.ly/2os7GPU>

<sup>2</sup> Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim - UNDP, Mozaiku i Kosovës 2015, faqe 37. Burimi: <http://bit.ly/1d30foS> (Hapur më 20 qershor 2017)

<sup>3</sup> Ibid. faqe 39

## Problemet aktuale të Komunës së Junikut

### **Menaxhimi i mbeturinave**

Menaxhimi i mbeturinave në komunën e Junikut vazhdon të jetë problem edhe në vitin 2017. Qytetarët ankohen se mbeturinat nuk largohen me rregull. Përgjatë rrugës kryesore në hyrje të Junikut, nga drejtimi i Gjakovës, vërehen grumbuj mbeturinash. Në raportin e UNDP-së është evidentuar përqindje e ulët në nivelin e kënaqshmërisë me shërbimin e mbeturinave, ku vetëm 9% e banorëve të Junikut janë të kënaqur me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të ngurta në komunën e tyre.

### **Prerja e pyjeve**

Bjeshkët e Junikut, të cilat janë të njohura për bukuritë natyrore dhe janë të shpallura park nacional, po dëmtohen dita ditës nga prerësit ilegal. Shqetësim për prerjen e pyjeve banorët kishin përmendur edhe në hulumtimin e GAP të vitit 2009.

### **Mungesa e tregut të gjelbër**

Projekti i ndërtimit të tregut të gjelbër është që nga viti 2013. Komuna ka identifikuar vendin për treg dhe ka arritur të bëjë marrëveshje bashkëpunimi. Por kjo tokë e ndarë nga komuna del të jetë problem me pronarët. Kështu, që nga viti 2013 asnjë hap konkret nuk është marrë nga ana e komunës për ta zgjidhur këtë problem. Ende tregtarët e tregut të gjelbër shesin në rrugët e qytetit.

### **Mungesa e çerdhes**

Juniku nuk ka çerdhe publike. Komuna ka marrë donacion nga Save the Children për ta rehabilituar qendrën rinore në çerdhe publike. Por kjo nuk ka ndodhë, pasi se po kjo qendër është shfrytëzuar prej fëmijëve për ta vijuar mësimin parashkollor.

### **Mungesa e stacionit të autobusëve**

Juniku ka mungesë të stacionit të autobusëve. Edhe pse lokacioni për pritje të autobusëve ekziston, mirëpo objekt nuk ka në këtë lokacion. Qytetarët janë të detyruar që të presin autobusin në ambient të hapur edhe gjatë reshjeve atmosferike.

## Fushave që komuna duhet t'u kushtojë vëmendje

### **Zhvillimi i turizmit**

Komuna e Junikut ka potenciale të mëdha në tërheqjen e vizitorëve. Kullat e vjetra rrethuar me vargmale të gjata dhe të larta ofrojnë një pamje piktoreske për vizitorët. Kjo përparësi duhet shfrytëzuar dhe Juniku duhet të ndërmarrë ndonjë fushatë informuese për të tërhequr vizitorët.


## Hapja e bizneseve hoteliere

Komuna e Junikut duhet të shoh mundësinë e inkurajimit të biznesit privat me qëllim të hapjes së bizneseve hoteliere për tërheqjen e vizitorëve. Përmirësimi i infrastrukturës është esenciale për zhvillimin e turizmit.

## Trendet buxhetore në Komunën e Junikut

Komuna e Junikut ka planifikuar buxhet prej 1.5 milion euro në vitin 2017.<sup>4</sup> Në këtë buxhet do të barten nga viti 2016 edhe rreth 18 mijë euro tjera nga të hyrat vetanake të pashpenzuara,<sup>5</sup> ndërsa në vitin 2013 janë bartur afër dy mijë euro më shumë se këtë vit.<sup>6</sup> Krahasuar me buxhetin e planifikuar të vitit 2013, Komuna e Junikut ka pasur një rritje të lehtë të buxhetit për rreth 200 mijë euro edhe pse përgjatë këtyre katër vitesh ka pasur lëvizje në ulje dhe rritje të buxhetit.

**Figura. nr.1:** Buxheti i Komunës së Junikut 2017




<sup>4</sup> Shih për më shumë platformën buxhetore të Institutit GAP në <http://bit.ly/2rMELbD>

<sup>5</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 63

<sup>6</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2012. Burimi: <http://bit.ly/2wKArJf>, faqe 60

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm shohim se Komuna e Junikut vazhdimisht ka ndarë pjesën më të madhe të buxhetit për paga dhe mëditje dhe trendi ka shkuar në rritje, përderisa investimet kapitale kanë pasur lëvizje të ndryshme, kryesisht gjatë vitit 2015 ka pasur rënie, për të shënuar ngritje në 2016 dhe 2017.

**Figura nr.2:** Trendët buxhetore në Junik 2013 dhe 2017




Kategoria e pagave dhe mëditjeve është rritur nga rreth 900 mijë euro euro në 2013 në rreth një milion euro në 2017. Kjo rritje mund t'i adresohet vendimit të kryeministrit në vitin 2014<sup>7</sup> për të rritur pagat në sektorin publik. Arsyetim për mos rritje më të madhe të pagave dhe mëditjeve në këtë rast mund të rezultojë nga reduktimi i personelit për 15 punëtorë. Por, Juniku këtë vit ka kontraktuar një person jashtë listës së pagave dhe 10 persona me kontrata të veçanta të cilët janë jashtë listës së pagave.<sup>8</sup>

Në kategorinë e investimeve kapitale të planifikuara, Juniku ka pasur rritje rreth 100 mijë euro duke përbërë 24% të buxhetit. Në krahasim me buxhetin total, kjo përbën rritje prej katër pikë përqindjeje nga buxheti i planifikuar i vitit 2013. Kategoria e subvencioneve dhe transfereve ka pësuar rënie jo shumë të madhe rreth një mijë euro dhe pjesëmarrja në buxhetin total vazhdon të mbetet e vogël me pothuajse 0%, ndërkaq para katër vitesh ishte 1%. Kategoritë e shpenzimeve komunale dhe e mallrave dhe shërbimeve po ashtu janë zvogëluar.

<sup>7</sup> Zyra e Kryeministrit, Vendimet e mbledhjes së 172-të të qeverisë . Burimi: <http://bit.ly/2w6MK0M>


<sup>8</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016. Burimi: <http://bit.ly/2eFtgKj>, faqe 83-84

**Figura nr.3:** Përqindja e pagave dhe investimeve kapitale në buxhetin e vitit 2017



Të hyrat komunale të Junikut mbeten solide shkaku i territorit jo të madh të komunës dhe mungesës së bizneseve të mëdha. Gjatë vitit 2016, Komuna e Junikut ka mbledhur të hyra prej 84 mijë eurove, shumë kjo simbolikisht më e lartë se të mbledhurat e vitit 2013 kur janë shënuar 75 mijë euro të hyra.

**Figura nr.4:** Të hyrat vetanake në Komunën e Junikut 2013-2016



Burimi. Zyra Kombëtare e Auditimit

## Rekomandime

Duke u bazuar në problemet kryesore, fushat të cilat kërkojnë vëmendjen e Komunës dhe trendet buxhetore, Instituti GAP rekomandon që qeverisja e komunës e dalë nga zgjedhjet lokale të 2017 të ndërmerret këto veprime:

- Komuna e Junikut duhet të shohë me prioritet zhvillimin e turizmit.
- Komuna e Junikut duhet të nisë zhvillimin e disa projekteve në formë të partneritetit publiko-privat veçmas sa i përket zhvillimit të turizmit.
- Komuna e Junikut duhet të rrisë shkallën e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile.
- Komuna e Junikut duhet treguar me rigorozë ndaj prerëseve ilegal të pyjeve.

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Ky projekt mbështetet nga:



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*